

PËR NJË RINI PA DUHAN

Duhani është shkaku kryesor i shumë vdekjeve që mund të shmangen. Është i vetmi produkt që konsumohet legalisht dhe që vret një të tretën, madje deri në një të dytën e atyre që e përdorin. Të rinjtë janë një target i pëlqyeshëm për industrinë e duhanit, e cila përpinqet vazhdimisht që të tërheqë konsumatorë të rinj. Nikotina është një substancë që krijon tërheqje të lartë. Për këtë arsy, fëmijët dhe adoleshentët që provojnë duhanin mund të krijojnë varësi shumë shpejt prej tij. Sipas studimeve pjesa më e madhe e njerëzve e fillojnë duhanin përpara moshës 18 vjeç. Afërsisht një e katërtë e këtyre të rinjve fillojnë të pinë duhan para moshës 10 vjeç. Sa më të vegjël të janë në moshë kur fillojnë të provojnë duhanin, aq më shumë mundësi ka që këta provues të kthehen në duhanpirës të rregullt në të ardhmen. Është provuar se ekspozimi direkt dhe indirekt ndaj reklamave të duhanit, së bashku me strategji të tjera marketingu që përdorin industritë e duhanit, çojnë në rritjen e numrit të të rinjve të cilët pinë duhan.

Industria e duhanit shpenzon dhjetëra- milionë dollarë çdo vit në mbarë botën për të reklamuar sa më mirë produktet e veta. Një nga mënyrat më efektive që shtetet mund të përdorin për të mbrojtur të rinjtë nga fenomeni në fjalë është duke ndaluar të gjitha llojet direkte dhe indirekte të reklamimit të duhanit, përfshirë promovimin dhe sponsorizimin e produkteve nga industria e duhanit, të çfarëdolloj aktiviteti.

Disa fakte:

- Një duhanpirës mund të vdesë 10 vjet më shpejt sesa bashkëmoshatarët të cilët nuk pinë duhan.
- Studimet kanë treguar se të rinjtë që janë të eksposuar ndaj duhanit në familje dhe në shoqëri kanë 90% më shumë mundësi të pinë duhan, sesa të rinjtë që nuk janë në situatë të tillë.
- Të rinjtë duhanpirës vuajnë më shumë nga kolla, astma dhe bronshiti.
- Të rinjtë që fillojnë duhanin në një moshë të re rrisin mundësinë që të krijojnë varësi nga nikotina dhe të vazhdojnë të pinë duhan edhe kur rriten.
- Pjesa më e madhe e të rinjve që pinë duhan duan ta lënë, por kanë shumë vështirësi.
- Varësia nga nikotina është më e madhe tek të rinjtë sesa tek të rriturit. Të rinjtë mund të krijojnë varësi nga nikotina brenda disa javësh nëse pinë dy - tre cigare në ditë.

Përse të rinjtë fillojnë të pinë duhan?

- Të rinjtë mund të fillojnë duhanin, sepse mendojnë se duhanpirja i bën të duken më të pjekur dhe më të rritur.

- Ata mund tē pinë duhan si shenjë revolte ndaj prindérve ose mësuesve.
- Pinë duhan që tē lirohen nga stresi.
- Pinë pér shkak tē presionit nga rrethi shoqëror. Nëse shokët e tyre pinë duhan edhe ata mund ta fillojnë.
- Fëmijët mund tē fillojnë tē pinë duhan, sepse mendojnë se mund tē dobësohen. Ata mendojnë se nëse e ndërpresin duhanin do tē shëndoshën

Cilat shenja tregojnë që fëmija juaj pi duhan?

Shenjet më tē zakonshme tē duhanpirjes te tē rintjtë janë: kollitje, irritim tē fytit, zë tē ngjirur, erë tē keqe nga goja, zverdhje e dhëmbëve, frymëmarrje e rënduar, ftohje tē shpeshta. Nëse fëmijës tuaj i vjen trupi dhe rrobat era duhan, përpara se ta akuzoni, pyeteni pér erën. Mund tē ndodhë që erën e rëndë ta ketë si rezultat i qëndrimit në ambiente me tym duhani ose ka qenë me shokë që kanë pirë, ndërsa ai vetë nuk e frekuenton.

Çfarë duhet tē bëni nëse fëmija juaj pi duhan?

- Flisni, komunikoni dhe pyeteni fëmijën tuaj, përsë pi duhan... Bisedoni rreth duhanit me vëmendje, duke mos e kritikuar. Gjatë bisedës përmendni efektet negative afatshkurtra tē duhanit (dhëmbë tē verdha, erë e keqe, çmimi etj). Fokusohuni në tē tashmen. Fëmijët shpesh nuk e kuptojnë se ky veprim mund tē ndikojë edhe në tē ardhmen.
- Mos lejoni qe fëmija tē pijë duhan në praninë tuaj. Të pirët duhan nën kontrollin tuaj nuk është më i sigurt. Përkundrazi, kjo e mëson se tē pirët duhan është e pranueshme.
- Mos e detyroni tē ndërpresë duhanin. Jepini kurajo në mënyrë që ta marrë vetë vendimin.
- Nëse fëmija juaj pohon se mund ta ndërpresë, nxiteni t'jua vërtetojë këtë; psh., kërkojini që mos tē pijë asnje cigare pér një javë rresht.
- Jepini mbështetje ta ndërpresë. Kërkonи ndihmë tē specializuar pér tē ndihmuar fëmijën tuaj tē lërë duhanin.
- Nëse fëmija juaj përpinqet ta ndërpresë, lavdërojeni nëse vëreni edhe suksesin më tē vogël. Shpërblejeni suksesin. Vëriti në dukje gjërat e mira që do tē dalin si rezultat i
- ndërprerjes së duhanit (shëndet më tē mirë, pamje më tē mirë, kursim parash etj).
- Nëse fëmija juaj frikësohet se mos shton në peshë pas ndërprerjes se duhanit, informojeni se ushtrimet fizike, shëtitjet dhe dieta e kontrolluar do tē japin peshën që ka pasur. Është e saktë se disa njerëz mundohen ta kompensojnë dëshirën pér cigare duke e zëvendësuar me ushqim.